



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 4480 Prot

Peshkopi, më 06.11.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.81**

Datë: 03.11.2025.

“Për emërtimin e *Sheshit në Qendër të Sllovës*”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 81 Datë 03/10/2025

“Për emërtimin e Sheshit në Qendër të Sllovës me emrin “Qatip Cala”


Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9/1.7 gërma “b” dhe nenit 54, gërma “ll”, neni 55 pika 2 të ligjit nr.139/2015, për “Vetëqeverisjen Vendore”, Këshilli Bashkiak mori në shqyrtim propozimin e bërë nga “Komiteti Kombëtar i Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ të Popullit Shqiptarë “Nderi Kombit” për emërtimin e sheshit të Sllovës Qatip Cala. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **03.11.2025** me 18 vota pro, 0 kundër dhe 1 abstenim:

VENDOSI

1. Të miratojë emërtimin e sheshit në qendër të Sllovës me emrin **Qatip Cala**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Dibër, Drejtoria e Shërbimeve Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi u shpall me datë **03.11.2025**

Kryetar i Këshillit Bashkiak





**KOMITETI KOMBËTAR I ORGANIZATËS SË VETERANËVE DHE PASARDHËSVE TË LANÇ
TË POPULLIT SHQIPTAR "NDERI I KOMBIT"**

Nr. 66/1 _ Prot.

Tiranë, më 10.04.2025

Lënda: Kërkesë për emërtimin e Sheshit të ... Sllovës në Bashkinë e Dibrës, të Patriotit të Atdheut dhe luftëtarit të Brigadës së 18-Sulmuese të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, **Qatip Cala.**

Drejtuar: Zotit Rahim Spahiu
Kryetar i Bashkisë së Peshkopisë ✓

Drejtuar: Znj. Irimi Shehu
Kryetare e Këshillit Bashkiak të Dibrës

Drejtuar: Shokut Alush Stojku
Kryetar i Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ
Bashkia Dibër.

I nderuar kryetar i Bashkisë Dibër,
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,
I nderuar Kryetar i Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it,
Bashkia Dibër, Alush Stojku,

ORGANIZATA E VETERANËVE DHE PASARDHËSVE TË LANÇ, TË POPULLIT SHQIPTAR, "NDERI I KOMBIT", në kuadrin e 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe fitores mbi Nazi-fashizmin, vlerësoi se përkujtimi i Dëshmorëve të Atdheut, si dhe i të gjithë familjeve të veteranëve që luftuan në mënyrë aktive dhe mbështetën LANÇ-in, të mernin vëmëndien e shtuar si nderi dhe krenaria e shqiptarëve, për rrezikun e marrë në sy familjarisht dhe individualisht si dhe gjakun e derdhur për çlirimin e Atdheut. Na mbetet një detyrim brezash në të gjithë vendin, që të përcjellim dëshirat e realizueshme të bijve e bijave të denjë të tyre.

Kërkesa jonë bazohet në kompetencat ligjore të Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Bashkive dhe Administratorëve bashkiakë që të mundësojnë emertimin e Sheshit në Qendër të ish Lokalitetit të Slllovës, "Sheshi Qatip Cala".

Populli i Dibrës është shquar në luftën për liri e pavarësi. Kontributi i tij zë vend të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë. Janë të njohura luftërat e Skënderbeut kundër Perandorisë osmane, ato të luftës kundër Tanzimatit, Hajredin Pashës, mbrojtja e Lidhjes së Prizrenit, Lidhjes së Pejës, kryengritjet e mëdha 1910-1912 e tjerë. Nëntë vjet iu desh Dibrës të luftojë për mbrojtjen e pavarësisë kundër copëtimit të saj nga pushtuesit serbë.

Në 1939-1944 filloi një luftë e re që për humbjet e jetëve njerëzore, të pasurisë së fituar me djersë gjatë shumë brezave ishin më të mëdha se luftërat që kish përballuar Dibra nga shumë pushtues të tjerë.

Pushtimi i Shqipërisë më 1939 nga Italia Fashiste e zemëroi popullin, rininë, inteligjencën dhe mbarë shoqërinë. U përdorën të gjitha format e luftës, demonstrat, njësitet guerile në qytete. U krijuan **Çeta partizane e Dibrës më 20 qershor 1942, Batalioni i Dibrës më 26 korrik 1943 dhe Brigada e 18 sulmuese më 18 gusht 1944 në Sllatinë të Dibrës së Poshtme me komandant Esat Ndreun.** Ajo përbëhej nga forcat partizane të Dibrës, Martaneshit, Çermenikës, si dhe mjaft të rinj që u inkuadruan për herë të parë në radhët e forcave partizane.

Më 23 gusht 1944 çliruan Peshkopinë dhe gjithë Dibrën. Formimi i brigadës 18 sulmuese dhe çlirimi i Dibrës janë dy ngjarje të rëndësishme të historisë së Dibrës Heroizmi i Hibe Palikuqit, Hamdi Lleshit, Jashar Kolës, Irfan Hajrullait, Demir Gashit, Liman Kabës etj, na bën që të ndjehemi krenar për gjakun e këtyre martirëve që sot gëzojmë lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Populli dibran, patriot e liridashës krenohet sot me veprën e lavdishme e të pa vdekshme , ku bijtë e tij, partizanët trima i dolën zot Atdheut, pavarësisht pasojave deri në sakrificimin e jetës në emër të lirisë. Me respekt të thellë kujtojmë heronjtë e popullit Haxhi Lleshi, Gjok Doçi, Nazmi Rushiti, Hibe Palikuqi, Liman Kaba si dhe dëshmorët Isak Metalia, Musa Agolli, Ramadan Veliu, Jashar Kola, Hamdi Lleshi, Riza Doda, Stefan Luarasi, Spiro Velko, Hamza Shehu, Tahsim Shehu, Irfan Hajrullai, Demir Gashi, Rukie Roshi, Ahmet Cami, Elez Mena, Ferit Xhajku, Rifat Manjani, Bajram Cara, Mustafa Bunguri, Aqif Konesha, Mehdi Topuzi, Xhemal Lita, Asllan Tanushi,, Asllan Kosiqi, Jaçe Hormova, Myrteza Zuna, Bilal Kanxholli etj, që dhanë jetën në emër të lirisë dhe atdheut.

...Dibra heroike i dha luftës antifashiste nacional-çlirimtare mbi 2.000 partizanë, 5 heronj populli, 33 dëshmorë, 230 shtëpi janë shpallur baza të luftës Nacional çlirimtare etj. Lufta dhe vepra e tyre do të kujtohen e respektohen brez pas brezi.

Komiteti Kombëtar i Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ, të Popullit Shqiptar, “ Nderi i Kombit”, i cili parashikon nderim dhe respektim të figurës së patriotëve, heronjve, dëshmorëve dhe veteranëve që janë dëshmorë të gjallë të Atdheut, është plotësisht e bindur dhe shpresëplotë në mbështetjen Tuaj në këtë propozim.

Bashkëlidhur në mënyrë kronologjike :

1. **Biografi** e patriotit të Atdheut, luftëtarit të Brigadës së 18-Sulmuese, QATIP CALA. (Dy fletë)
2. Çertifikatë e Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 1455, dt **3 Maj 1946** dekorohet Qatip Cala me Medaljen e Çlirimit.
3. Dekret Nr. 2178, dt **5-12-1955**, për dekorim nga Presidiumit të Kuvendit Popullor me Medaljen e Trimërisë
4. Çertifikatë e datës **08-11-1969** e Komitetit Ekzekutiv, KP Rrethit Dibër për vendosjen e pllakës përkujtimore në shtëpinë e Qatip Cala.
5. Dekorim me Medaljen e Punës nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Nr. 4755, date **24.10.1970**.
6. Letër Përgëzimi e nderimi nga Haxhi Lleshi në **fund-vitin 1971** për arritjet e larta si kryetar i Kooperativës së Sllovës.
7. Fletë Lavdërimi e **vitit 1973** nga Komandanti e komisarari i Rep Ushtarak 3900 për rezultate të larta në përgatitjen Politiko-luftarake.
8. Fletë- Nderi nga Ministri i Industrisë dhe Minierave, Pali Miska. (pa datë, por sipas Web është **1977-'78**)
9. Komiteti Qëndror i PPSH më **10. 10 1981** i jep Urdhërin “40-Vjetori i PPSH”
10. Libreza e Veteranit e **vitit 1999**
11. Medalje për kontribut të shquar në çlirimin e atdheut nga Këshilli i Ministrave Nr 895, Dt. **29-11-2004**
12. Fletë-Nderi nga Komiteti i Veteranëve të Luftës të rrethit Dibrës (Viti **2005**)
13. Kronologjia mbajtur nga Veterani Dibran, Selim Pira më **12.09.2006**.
14. Mesazh Përkujtimor nga Komiteti i Veteranëve të LANÇ Tiranë më **15-02-2007**.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

VELIMYETARI



KRYETAR

Prof. Dr. HULUSI HAKO

